

VENDIM
Nr.1147, datë 5.8.2008

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.289, DATË 17.5.2006 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E AGJENCISË SË
LEGALIZIMIT, URBANIZIMIT DHE INTEGRIMIT TË ZONAVE/NDËRTIMEVE
INFORMALE (ALUIZNI)”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4 e 46 të ligjit nr.9482, datë 3.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.289, datë 17.5.2006 të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

1. Pika 2 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“2. ALUIZNI ka drejtorinë qendrore në Tiranë, dhe drejtori, në nivel qarku, e zyra, në këto njësi të qeverisjes vendore:

a) Bashkia Tiranë	7 zyra
b) Bashkia Kavajë	1 zyrë
c) Bashkia Kamëz	1 zyrë
ç) Komuna Paskuqan	1 zyrë
d) Bashkia Vlorë	1 zyrë
dh) Bashkia Sarandë	1 zyrë
e) Bashkia Orikum	1 zyrë
ë) Bashkia Durrës	2 zyra
f) Bashkia Fushë-Krujë	1 zyrë
g) Komuna Manzë	1 zyrë
gj) Bashkia Laç	1 zyrë
h) Bashkia Korçë	1 zyrë
i) Bashkia Pogradec	1 zyrë
j) Bashkia Lushnjë	1 zyrë
k) Bashkia Fier	1 zyrë
l) Bashkia Berat	1 zyrë
ll) Bashkia Elbasan	2 zyra
m) Bashkia Shkodër	1 zyrë
n) Komuna Bushat	1 zyrë.”.

2. Pika 5 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“5. ALUIZNI drejtohet nga Drejtori i Përgjithshëm dhe 3 zëvendës drejtorë.”.

3. Pika 8 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“8. ALUIZNI financohet nga Buxheti i Shtetit, nga të ardhurat, që siguron nga mbledhja e tarifës së shërbimit, në përputhje me ligjin nr.9482, datë 3.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar, dhe nga donacione të huaja.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha